



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2024:077625  
Datë: 11.12.2024  
Numri i dokumentit: 06584168

ARJ.nr.128/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare, Ragip Namani dhe Nenad Lazic anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Faton Xhaqaj, në çështjen juridike sipas padisë në konflikt administrativ të propozuesit: “E. R.” Shpk., me seli në P., me nr. Unik Identifikues të biznesit ..., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit të zëvendësit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të propozuesit - paditësit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.1049/24, të datës 28.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 09.12.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paraqitur nga paditësi - propozuesi “E. R.” Shpk., me seli në P., me nr. Unik Identifikues të biznesit .., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Shk.II.nr.1049/24, të datës 28.05.2024.

## A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin K.A.nr.124/24, të datës 14.03.2024, ka vendosur: Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit: “E. R.” Shpk., me seli në P., me nr. Unik Identifikues të biznesit ..., për shfuqizimin e vendimit për dhënien e pëlqimit mjedisor Nr. Prot: ..., të datës 22.02.2023, për shfuqizimin e vendimit për dhënien e pëlqimit mjedisor Nr. Prot: ..., të datës 22.12.2022, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor, përkitazi me padinë e paditësit.

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e propozuesit paditësit “E. R.” Shpk., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr.124/24, të datës 14.03.2024, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, paditësi - propozuesi në afat ligjor ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim, që të: Aprovohet si e bazuar kërkesa e paditësit, dhe të anulohet aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr.1049/24, i datës 28.05.2024, i Gjykatës Komerciale të Kosovës -Departamenti për Çështje Administrative - Dhomës të Shkallës së Dytë dhe të aprovohet kërkesa e paditësit dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.prot., të datës 22.02.2023, për shfuqizimin e vendimit për dhënien e Pëlqimit Mjedisor nr. prot. ..., të datës 22.12.2022, si dhe të obligohet e paditura për pezullimin e të gjitha procedurave dhe aktiviteteteve për pengimin e ndërtimit të Fabrikës për trajtimin termik të mbeturinave për përfitimin e energjisë elektrike, në V., Komuna e F., deri në vendosjen meritorë sipas padisë.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së, mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të Dhomave të shkallës së dytë dhe atë të dhomave të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se: Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton më datë 08.03.2024, paditësi - propozuesi “E. R.” Shpk., me seli në P., ka iniciuar konflikt administrativ ndaj të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës, Nr.Prot: .. të datës 22.02.2023, për shfuqizimin e vendimit për dhënien e pëlqimit mjedisor Nr. Prot: .., të datës 22.12.2022, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, duke vepruar sipas propozimit të paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës gjyqësore ka nxjerr aktvendimin K.A.nr.124/24, të datës 14.03.2024, me të cilin ka vendosur ta refuzoj propozimin e paditësit – propozuesit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, lidhur me pajtueshmërinë e shtyrjes së ekzekutimit të vendimit administrativ me interesin publik, gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e paditësit se vendimi nr.prot; .., të datës 22.02.2023, për shfuqizimin e vendimit dhe dhënien e pëlqimit mjedisor Nr. Prot: .., të datës 22.12.2022 pëlqimi mjedisor anulohet me arsyetim se është vërtetuar se Raporti i VNM-së me të gjeturat e Inspektoratit përmban të dhëna të pasakta të cilat kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes si dhe përmbajtja e Raportit të VNM-së është në kundërshtim me nenin 14 të Ligjit Nr.08/L-181, për vlerësimin e ndikimit në mjedis me çka është degraduar procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përmes raportit të paraqitur nga ana e kompanisë dhe hartuesve, si pasojë e të gjeturave, Komisioni i VNM-së ka iniciuar tërheqjen e licencave të hartuesve. Paditësit nuk kanë ngritur asnjë pretendim se shtyrja e ekzekutimit të vendimit administrativ të goditur nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, e aq më pak kanë paraqitur prova për ta provuar plotësimin e kushtit të dytë nga neni 22 paragrafi 2 të LKA- së.

Po ashtu vendimin me nr. protokollit 5905-2/22 i datës 29.12.22, kompania “E. P.” SHPK., P., pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: Fabrikën për ndërtimin termik të mbeturinave, për përfitimin e energjisë elektrike në V., F., në ngastrën kadastrale, ..., V. F., vendim ky i kushtëzuar me respektimin e kushteve gjatë fazës së ndërtimit, siç janë: normat e shkarkimeve në ajër nga makineritë dhe pajisjet e rënda të ndërtimit, niveli i zhurmës, sasia e pluhurit nga qarkullimi i automjeteve [...] gjatë fazës së operimit, të ndërtohet impianti për trajtimin e ujit industrial, trajtimin e urave kimike, trajtimin e ujerave biologjike, të vendosen teknikat me të mira në disponim (IMM) për zvogëlimin e grimcave të pluhurit (PM) dhe gazrave shkarkuese - Precipitatorët elektrostatik (PES) si dhe filterat me thasë, të vendosen teknikat me të mira në

disponim (IMM) për zvogëlimin e oksideve të azotit në gazrat dalëse, të vendosen teknikat më të mira në disponim (IMM) për zvogëlimin e emisioneve të SO<sub>2</sub>, të vendoset sistemi për monitorimin kontinual të emisioneve në ajër, të bëhet monitorimi kontinual ujerave shkarkuese, rezultatet e kryera laboratorike të i raportohen Ministrisë në bazë të marrëveshjes, të sigurohen kontejner të posaçëm për deponime të ngurta në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë i pastër, të përgatitet dhe implementohet plani aksional për raste aksidenti; [...] Në raport janë paraparë të gjitha masat mbrojtëse efikase të mjedisit ku operatori obligohet ti përmbahet këtyre masave, gjatë punës në fabrikën për trajtimin termik të mbeturinave për përfitimin e energjisë elektrike në V., F., duhet respektuar të gjitha masat mbrojtëse sipas ligjeve në fuqi si dhe rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së, me paralajmërim se nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet. Andaj në rastin konkret nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të aprovuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata vlerëson se duke pas parasysh arsyen e anulimit do të ishte në dëm të interesit publik që Fabrika për ndërtim termik të mbeturinave, për përfitimin e energjisë elektrike të vazhdoj përderisa ekziston dyshim në vërtetësinë e të dhënave të pasakta të cilat kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, përderisa ekzistojnë dyshime në përmbajtjen e Raportit të VNM-së, për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për të cilat arsye e paditura e ka vlerësuar se është degraduar procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përmes raportit të paraqitur nga ana e kompanisë dhe hartuesve. Në të kundërtën, pa paragjykuar ligjshmërinë e vendimeve të kundërshtuara, degradimi potencial i mjedisit do të krijonte pasoja të pariparueshme në mjedis e të pa kompenzueshme financiarisht. Prandaj, çdo dëm financiar do të ishte më lehtë i riparueshëm në krahasim me riparimin e dëmëve që potencialisht rrezikon të krijohen po që se pezullohet ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar, e që edhe dëmi i interesit publik dhe dëmi që do ta pësonte e paditura do të tejkalonte dëmin financiar që do ta pësonte paditësi.

Andaj, duke qenë se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, ndërsa paditësi nuk ka arritur që të argumentojnë plotësimin e tyre ashtu siç parashihet me dispozitën ligjore të lartcekur, gjykata vendosi që të refuzojë kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi - propozuesi ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Kom.Dh.Shk.II.nr.1049/24, të datës 28.05.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e paditësit - propozuesit, ndërsa aktvendimin e

gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetua, duke vendosur si në dispozitën të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, në arsyetim të aktvendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 paragrafi 2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Edhe kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë njëjtë si gjykata e shkallës së parë vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit paditësit nuk do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së.

Pretendimet ankimore të palës paditëse/propozuese, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshkohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 paragrafi 2 dhe 6 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i dhomave të shkallës së dytë gjen se Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.

Kolegji i Gjykatës Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pas shqyrtimit të kërkesës së propozuesit - paditësit, vendimit të ankimuar të Gjykatës Komerciale e Kosovës- Dhomat e shkallës së dytë dhe Dhomat e shkallës së parë gjen se: gjykatat e instancave më të ulëta kanë

vendosur drejtë si në aktvendimet e tyre të apeluara, bazuar në nenin 22 të LKA-së, të cituar si më lartë, me refuzimin të kërkesës/propozimit të propozuesit - paditësit nga dhomat e shkallës së parë dhe ankesës nga dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës së Komerciale si të pabazuar, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të organit të paditur Nr. Prot: .. të datës 22.02.2023, për shfuqizimin e vendimit për dhënien e pëlqimit mjedisor Nr. Prot: .., të datës 22.12.2022, sepse edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi nuk e ka bërë të besueshme me prova bindëse dhe të dëshmuara që me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur do të shkaktohej dëm i pa riparueshëm apo i cili vështirë do të riparohej, prandaj nuk provohet se në këtë rast janë plotësuar kushtet kumulative ashtu si parashihet në nenin 22 paragrafi 2, të LKA-së, se cili është dëmi i pa riparueshëm, dhe a janë plotësuar edhe kushtet tjera në mënyrë kumulative, që shtyrja është apo jo në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do të sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, në mënyrë që gjykata të vendos për shtyerjen ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Prandaj kjo gjykatë vendosi që kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur kundër aktvendimit të Dhomës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, Kom.Dh.Shk.II.nr.1049/24, të datës 28.05.2024, ta refuzoj si të pa bazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor se aktvendimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, është pretendim i pabazuar, për shkak se aktvendimi është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktvendimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale dhe ka rezultuar si në dispozitivin e aktvendimit të shkallës së parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktvendimin e Dhomës së shkallës së dytë, sepse gjykata e Dhoma e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktvendimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha

pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pretendimet e propozuesit - paditësit si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: pala paditëse ka filluar punimet dhe ndërtimin e fabrikës dhe si rrjedhojë janë investuar afërsisht mbi 20 milion euro dhe janë lidhë kontrata për qiranë e tokës dhe se përveç vlerës së investuar rrezikon në mënyrë esenciale tërë zhvillimin e projektit, kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe bindëse për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe për tu aprovuar kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësorë. Nga provat e ofruara nga propozuesi - paditësi, është evident fillimi i investimeve të investitorit dhe lidhja e kontratave sa i përket qirasë së pronës këtu paditësit, mirëpo nga provat e ofruar nuk mund të vërtetohet dëmi vështirë i riparueshëm nëse nuk aprovohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues. Në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për dëm vështirë të riparueshëm, sepse kemi të bëjmë me të paditurën që është organ publikë dhe në vete përmban buxhet të mjaftueshëm në rast eventual të kompensimit të dëmit të paditësit, në të kundërtën vazhdimi i punimeve nga ana e paditësit do të rrezikonte vetë paditësin të cilit ka rrezik të shkaktohet dëm edhe më i madh se sa që pretendon paditësi në këtë rast, prandaj nga provat që i ka paraqitur propozuesi - paditësi nuk dëshmohet qartë dhe saktë se me ekzekutimin e vendimit të të paditurës të kontestuar me padi, shtyrja e të cilit kërkohet, propozuesit - paditësit do të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohet, e po ashtu nuk e ka bërë të besueshme pretendimin se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe që do të sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, ashtu si parashihet në nenin 22 paragrafi 2 dhe 6 të LKA-së.

Pretendimet e paditësit - propozuesit se gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e saj e ka marrë në kundërshtim me nenin 182 paragrafi 2 pika c) të LPK-së, me pretendimin se i njëjti gjyqtar në shkallë të dytë, në të njëjtën çështje për të njëjtat palë ka vendosur edhe me vendimet paraprake të qështjes kontestuese, Gjykata Supreme këto pretendime i refuzoi si të pa bazuara. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të lartcekura për faktin se gjyqtari për të cilin pretendon paditësi - propozuesi, është gjyqtarë në Gjykatën e dhomave të shkallës së dytë dhe se nuk ka pengesa ligjore që të vendos për të njëjtat palë për të njëjtën çështje (për vendime të ndryshme) në gjykatën e njëjtë, qoftë si kryetar i kolegjit apo si anëtar. Pretendimi i paditësit-propozuesit është i pa bazuar për faktin se një pretendim i tillë vjen në shprehje vetëm

kur gjyqtari i cili ka vendosur më parë për çështjen e njëjtë në gjykatën e shkallë së parë, nuk ka të drejtë të vendos në instancat më të larta për të njëjtën çështje dhe se kjo është e rregulluar me nenin 67 pika d) të LPK-së, në të kundërtën nuk ka pengesa ligjore për një gjë të tillë.

Ndërsa gjykata pati parasysh edhe pretendimet e tjera të paditësit me kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit, mirëpo erdhi në përfundim se të njëjtat pretendime kishin të bënin me çështjen kryesore që do të zhvillohet me padi dhe jo me rrezikun që do ti kanosej paditësit dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, dhe këto pretendime nuk shqyrtohen në fazën e vendosjes lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit ashtu siç parashihet në nenin 22 paragrafi 6 të LKA, por ligjshmëria e tyre vlerësohet gjatë vendosjes meritore të çështjes në procedurë të rregullt sipas padisë së paditësit e cila është parashtruar së bashku me kërkesën për shtyrje ashtu siç parashihet në nenin 22 paragrafi 3 të LKA.

Nga gjendja e elaboruar si më lartë Gjykata Supreme vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sipas gjendjes së fakteve të vërtetuara që kanë qenë me ndikim për refuzimin e ankesës së propozuesit - paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të organit të paditur. Në këtë çështje edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të propozuesit - paditësit.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54, paragrafi 1, lidhur me nenin 22, paragrafi 2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

ARJ nr.128/2024, me datë 09.12.2024

B. Profesional,  
Faton Xhaqkaj

Kryetarja e kolegjit,  
Franciska Zhitija - Ymeri